



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
QËNDRA SPORTIVE KORÇË SH.A**

RELACION

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMI NR.19 DATË 25.01.2023 PËR MIRATIMIN E
TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPIN E PARË DHE AKADEMINË
SKËNDERBEU PËR VITIN 2023”**

Me vendimin nr.19 datë 25.01.2023 është miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë, në rolin e Asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të Qendrës Sportive Korçë Sh.a, trajtimi ushqimor dhe i dietave për ekipin e parë dhe Akademinë “Skenderbeu” për vitin 2023. Trajtimi ushqimor është caktuar në vlerën 50 000 lekë në muaj dhe për person për 30 sportistë (futbollistë dhe staf) për 10 muaj.

Kjo pagesë është kryer nga Bashkia duke e transferuar fondin tek Qendra Sportive Korçë Sh.a. Qendra Sportive Korçë Sh.a kryen pagesat mujore për 30 sportistë të federuar sipas listës së firmosur nga drejtuesit e Klubit të Futbollit Skënderbeu.

Iniciativat financuese në sport nga ana e pushtetit vendor janë një detyrim ligjor i Bashkive. Një detyrim që rrjedh nga dispozitat e mëposhtme:

Bazuar në ligjin Nr. 79/2017 “Për Sportin” ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020:

- Neni 8 “Ministria përgjegjëse për sportin dhe njësitë e qeverisjes vendore” pika 3:

Njësia administrative e pushtetit vendor harton dhe garanton politikën vendore në fushën e sportit shkollor, sportit për të gjithë dhe sportit elitë, krijon institucione përgjegjëse për sportin, menaxhon objektet sportive, që ka në pronësi, ndërton objekte të reja, sipas nevojës, mbështet zhvillimin dhe veprimtarinë e organizatave sportive që zhvillojnë veprimtari në territoret e tyre.

- Neni 21 “Klubet sportive” pika 4

Klubet sportive sipas pikës 1 të këtij neni, përfitojnë financim nga organet e pushtetit vendor, në zbatim të dispozitave të legjislativës në fuqi, nëpërmjet transferimeve dhe ngaburimeve të tjera të ligjshme.

- Neni 39 “Financim i gabuar buxheti i shtetit” pika 2

Në financimin e sportit përfshihen edhe burimet financiare nga pushteti vendor, organizatat sportive, federatat ndërkombëtare sportive, bastet sportive, donacionet, sponsorizimet, e drejta televizive, reklama dhe nga ndonjë burim tjetër i ligjshëm

Duke pasur në konsideratë impaktin social dhe ekonomik të rritjes së shpenzimeve nga ana e futbollistëve dhe stafit të klubit Skënderbeu si dhe duke e konsideruar si një stimul motivues për ecurinë sportive të klubit, pas kalimit të tij në ligën superiore, rezulton e domosdoshme një rritje e masës së trajtimit ushqimor të futbollistëve dhe stafit.

I propozohet Këshillit Bashkiak ndryshimi i masës së trajtimit ushqimor në vlerën 57 000 (pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë, për 30 sportistë (futbollistë dhe staf). Efektet financiare do të nisin nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të Këshillit Bashkiak.

Nëpërmjet këtij relacioni i kërkojmë Këshillit Bashkiak Korçë, si aksionar i vetëm i Shoqërisë Aksionare “Qendra Sportive Korçë” të miratojë ndryshimin e Vendimit nr.19 datë 25.01.2023 vetëm për pikën 1 të tij, në lidhje me masën e trajtimit ushqimor e cila kalon në vlerën 57 000 (pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

Si konkluzion, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”; bazuar në ligjin për 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar; bazuar në Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë “Qendra Sportive Korçë Sh.a”; bazuar në ligjin nr.79/2017 “Për Sportin” i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë, duke ushtruar funksionet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Qendrës Sportive Korçë Sh.a, si zotërues i 100% të aksioneve të kësaj shoqërie, të miratojë ndryshimin e Vendimit nr.19 datë 25.01.2023 për pikën 1 të këtij vendimi duke përcaktuar masën e trajtimit ushqimor në vlerën 57 000 (pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

Luis Qirinxhi Emil Kamburi

